

**Prof. Dr. AFRIM SELIMAJ**

**Prorektor, universiteti "Haxhi Zeka", Pejë**

### **Fjala e mirëseardhjes**

*I nderuar deputet i Parlamentit të Kosovës z. Ali Lajçi, të nderuar kryesi e Klubit Intelktualët e Rugovës, të nderuar profesorë, studiues universitarë nga trojet e Ballkanit, nga Shkodra, nga Tirana, Elbasani, Gjirokastra, Shkupi, Prishtina, Ulqini, Plava dhe Gucia. Të nderuar bashkëvendës të Rugovës, të nderuar mysafirë të pranishëm. Më lejoni që fillimisht në emër të Universitetit "Haxhi Zeka" të falënderoj Klubin e Intelktualëve të Rugovës, Këshillin organizativ dhe të gjithë ata që kontribuuan në forma të ndryshme për organizimin dhe përgatitjen të këtij simpoziumi shkencor.*

Jemi mbledhur sot këtu në këtë simpozium shkencor, qe i kushtohet 100-vjetorit të masakrës së Shtupeqit dhe të katundeve të tjera të Rugovës, që ishte ndër masakrat më të tmerrshme që ndodheshin aso kohe nga Serbia dhe Mali i Zi me të vetmin qëllim shfarosjen e popullatës së asaj kraihine vetëm se ishin shqiptarë, përkatësisht shfarosjen dhe thyerjen e asaj kraihine që ishte rajoni me i pathyeshëm ndër vite, nga burrat dhe gratë e Rugovës që qëndruan dhe e mbrojtën kufirin nga Mali i Zi. Konsideroj që ky simpozium është një përpjekje që ne të mos harrojmë të kaluarën tonë, të ndriçojmë historinë për të cilën duhet të krenohemi, sepse ne ishim viktimat dhe po ua përkujtojmë brezave të rinj rrugëtimin tonë të përgjakshëm ndër vite. Për të mos marrë më shumë kohë, të gjithë kumtuesve u uroj prezantim të suksesshëm dhe punë të mbarë. Lavdi të gjithë atyre burrave dhe grave të masakrave të viteve 1919! Lavdi të gjithë atyre qe ranë ndër vite në krahinën e Rugovës duke e mbrojtur kufirin deri në luftën e fundit të vitit 1999! Ju faleminderit!

